



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 49 të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr. 28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e shtatë të rregullt, e mbajtur më datën 28.09.2020, merr këtë:

V E N D I M Nr.53/2020/KG

për formimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave juridiko-pronësore të qytetarëve

Neni 1

Për anëtarë të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave juridiko-pronësore të qytetarëve emërohen:

1. Snežana Jovanović - asamblete e Kuvendit Komunal
2. Vidak Ristović - asamblist i Kuvendit Komunal
3. Goran Milenković - asamblist i Kuvendit Komunal
4. Nikola Marinković - zyrtar i Drejtorisë së Kadastër
5. Nataša Dimitrijević - zyrtare e Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Mjedisit

Neni 2

Komisioni është i detyruar që pas përfundimit të punës ta përpilojë raportin dhe të njëjtin t'ia dorëzojë Kuvendit Komunal dhe kryetarit të komunës.

Neni 3

Mandati i komisionit përfundon me qasjen në të gjitha kërkesat dhe dorëzimin e raporteve.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Ljubica Karadžić